



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.65/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Afijete Sada Glllogjani dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fatjona Bekteshi, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Rrustem Ademaj nga Finlanda, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen me datën 6 tetor 2019, në seancën e panelit të mbajtur me 22.09.2019, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar apeli Anr.65/2019 i datës 20.09.2019, i parashtruar nga Rrustem Ademaj nga Finlanda, me të cilin kërkon që të përfshihet në listën e votuesve jashtë Kosovës.

A r s y e t i m

Me datën 20.09.2019 PZAP-i ka pranuar një apel nga Rrustem Ademaj nga Finlanda, në të cilën pretendohet se të njëjtit i është shkelur e drejta për të votuar.

Parashtruesi i apelit për vertetimin e pretendimeve të tij apelit i ka bashkangjitur keto dokumente: formularin e ankesës, formularin e aplikimit për votim jashtë Kosovës, kopjen e letërnjoftimit, vendvotimin aktual.

Ne përgjigjen në apel të datës 21.09.2019 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) thekson se parashtruesi Rrustem Ademaj ka dërguar aplikacion për regjistrim gjatë periudhës së aplikimit për regjistrim dhe me kopje të dokumenteve valide me të cilat plotëson kushtet për t'u përfshirë në listën e votuesve jashtë Kosovës.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimet e apelit, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, pasi shqyrtoi lëndën konstatoi se apeli është i pabazuar pasi që parashtruesi i apelit gjatë aplikimit të tij për regjistrim për votim jashtë Kosovës nuk i ka plotësuar kriteret të cilat kërkohen në bazë nenit 90 të LZP-së ku cekën në menyre taksative se cilat konsiderohen si

dokumente të pranueshme të identifikimit për procesin e zgjedhjeve perkatesisht pika a) ku ceket “*letërnjoftimi i vlefshëm*”, si dokument i pranueshmë i identifikimit dhe dispozita e nenit 3.1 të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së ku përcaktohet se: “*votuesi me zotësi juridike jashtë Kosovës mund ta hedh fletëvotimin për zgjedhjet në qoftë se është regjistruar si banorë i përhershëm i Kosovës në Regjistrin Qendror civil*”.

Nga shkresat e lëndës Paneli gjeti se parashtuesi i apelit në momentin e aplikimit për regjistrim për votim jashtë Kosovës nuk ka ofruar dokument të vlefshëm të identifikimit (letërnjoftimi i skaduar) sipas nenit 90 pika a) të LPZ-së dhe nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par.3, 118 par.1, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 65/2019 më datën 22.09.2019.

Kryesues i Panelit

Faton Ademi



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.